

URREJTJA MË BËN TË NDIHEM...



Hate hurts.

Raporto atë dhe ndalo atë.

#Hate Hurts SYP



South Yorkshire

POLICE

'Urrejtja' mund të jetë çdo incident ose krim i motivuar nga paragjykimi ose egërsia (ose perceptohet të jetë e tillë) kundër racës së një njeriu, fesë, orientimit seksual, identitetit transgjenital ose aftësisë së kufizuar.

Ajo përfshin:

- Një vepër penale, ku ligji është thyer, është një krim urrejtjeje.
- Një incident që nuk është vepër penale është një incident urrejtjeje.

Gjithë "Urrejtja" shqyrtohet nga policia, por jo të gjitha rastet janë vepra penale, ato që janë, si dhe incidentet e urrejtjes, do të regjistrohen.

Çfarë është një krim urrejtjeje?

Krim urrejtjeje është një vepër penale motivuar nga paragjykimi ose egërsia (ose perceptohet si e tillë) kundër një personi:

- **Paaftësia** – fizike, dëmtimi i dëgjimit dhe shikimit, sëmundja e shëndetit mendor dhe paaftësia e të mësuarit
- **Raca** – kombësia, ethnia, lëkura dhe trashëgimia
- **Feja** – besimi, besimi jo-fetar
- **Orientimi Seksual** – njerëz që identifikohen si lesbike, gei, bi-seksuale ose heteroseksuale
- **Identiteti gjinor** – njerëz që identifikohen si "trans" përfshirë njerëzit transgjinorë dhe transseksualë.

Kjo mund të përfshijë gjëra të tilla si:

- Sulm fizik. Dëmtim të pronës. Mbishkrime fyese. Zjarrvënie.
- Nxitje të urrejtjes on line.

Kjo listë nuk është tërësore; krimi i urrejtjes mund të jetë i motivuar nga lloje të ndryshme të paragjykitimit. Ne, gjithashtu, monitorojmë dhe regjistrojmë incidente të motivuara nga karakteristika të tjera siç është mosha, dhe nënkultura të veçanta si goth, punk dhe emo.

Çfarë është incidenti i urrejtjes?

Policia mund të ndjekë penalisht, kur ligji është thyer, por gjithashtu, do të dijë rreth incidenteve të urrejtjes jo-kriminale. Këto incidente mund të mos jenë vepra penale, por shpesh mund të ndihen si krime për ata që janë të prekur dhe në disa raste mund të përshkallëzohen; prandaj, ne punojmë me partnerë për tu përpjekur dhe për ti parandaluar ato që të ndodhin. Incidentet e urrejtjes jo-kriminale përfshijnë gjëra si komente ofenduese dhe fyese, on line, në prani ose me shkrim.

**URREJTJA
MË BËN TË
NDIHEM...**



Raportojë atë. Çdokush mund të jetë viktimë e urrejtjes.

Krimi i urrejtjes ose incidentet mund të ndodhin kudo – në shtëpi, në rrugë, në punë ose në shkollë. Askush nuk duhet të jetojë me frikë, ankth dhe pasojat e urrejtjes.

Nëse je viktimë ose dëshmitar i urrejtjes, raportimi i saj do të na ndihmojë të merremi me të dhe të parandalojmë që këto incidente t'i ndodhin dikujt tjetër. Ju, gjithashtu, do të na ndihmonit të kuptonim shkallën e incidenteve të urrejtjes në zonën tuaj, në mënyrë që mund tu përgjigjemi sa më mirë.

Është e rëndësishme që nëse urrejtja ndodh ndaj jush ose dikujt që ju njihni, raportojë atë dhe ndaloje atë.

Si të raportosh një krim urrejtjeje ose incident?

- Telefono **101** për jo- emergjencë ose **999** në rast emergjence.
- Nëse je i shurdhër, ke vështirësi në dëgjim ose në të folur, dërgo një text në **18001 101** ose një mesazh në **07786 220 022**.
- Vizito ose kontakto Qendrën Lokale të Raportimit të Krimin të Urrëjtjes, **lista e plotë është e vlefshme në website tonë**.
- Ju, gjithashtu, mund të raportoni krimin e urrejtjes nëpërmjet website tonë ose në Tru Vision (**report-it.org.uk**)
- Për më shumë informacion vizito: **southyorks.police.uk/hatehurts**